



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:101039

Datë: 26.06.2019

Numri i dokumentit: 00378833

PKR.nr.70/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti për Krime të Rënda, duke vendosur sipas kryetarit të trupit gjykues Naser Maliqi, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale ndaj të pandehurit R. B., nga fshati Feriçevë, Komuna e Kamenicës, të cilin sipas autorizimit e mbron av.Selman Sadiku nga Kamenica, për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRKsë, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.76/2019 e datës 08.05.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më 24.06.2019 shpall, ndërsa më 26.06.2019 përpilon:

AKTGJYKIM

Ndaj të pandehurit R. B., nga babai dhe nëna, i lindur më në fshatin Feriçevë, Komuna e Kamenicës, me vendbanim në lagjen “Malësia”, në Komunën e Kamenicës, jeton dhe vepron në Suedi, ka të kryer shkollën e fillore, i martuar, penzioner, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe shtetas Suedez.

**ËSHTË FAJTOR
SEPSE**

I

Nga data 14.09.2001 deri në muajin shkurt 2019 në kohë të papërcaktuar në lagjen “Malësia” në Kamenicë, i pandehuri pa autorizim dhe pa leje valide e në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët ka mbajtur në pronësi një pushkë gjuetie dy tytëshe, prodhim rus, kalibri 16mm, me numër serik AN 49167, e cila dyshohet se është vjedhur nga M. M. dhe K. B..

- Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të nenit 4,41,42,43,46, 69, 73,74,75,76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 233, 365, 450 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

E GJYKON

Të pandehurit R. B. gjykata i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 350 (treqind e pesëdhjetë) €, të cilën shumë i njëjti do ta paguajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në të kundërtën ky dënim me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg.

Detyrohet i pandehuri R. B., që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) euro dhe shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Të pandehurit R. B. i konfiskohet arma- pushkë gjuetie dy tytëshe, prodhim rus, kalibri 16mm, me numër serik AN 49167 dhe e njëjta do të asgjësohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, më 08.05.2019 ka ngritur aktakuzën PP.I.nr. 76/19, ndaj të pandehurit R. B., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar nga gjykata që ta shpall fajtor dhe t'i shqiptojë një sanksion penal të paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Kryetari i trupit gjykues, më 24.06.2019 ka mbajtur seancën fillestare, në të cilën kësaj gjykate i është dorëzuar një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe të pandehurit R. B. me mbrojtësin e tij avokatin Selman Sadiku.

Gjykata ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit, nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.

Gjykata ka aprovuar këtë marrëveshje për pranim të fajësisë, për shkak se ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare, pa imponim dhe pa asnjë presion, duke i ditur pasojat e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata ka pasur parasysh sjelljen e mirë të të pandehurit në gjykatë, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pa asnjë hezitim, pendimin për veprën e kryer dhe kërkim faljen.

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka konfiskuar armën e llojit- pushkë gjuetie dy tytëshe, prodhim rus, kalibri 16mm, me numër serik AN 49167.

Gjykata të pandehurin e ka detyruar që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë eurove) dhe shumë prej 50 (pesëdhjetë)€ në emër të viktimave të krimit.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.70/2019
Më 26.06.2019

Zyrtarja ligjore
Fikrete Destani

Kryetari i trupit
Naser Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2019:101039
Datë: 26.06.2019
Numri i dokumentit: 00378833